



PËRMBLEDHJA E RASTIT TË ARBITRAZHIT

TABELA E PËRMBAJTJES

| | | |
|-----|--|-------------------------------------|
| 1. | Përmbledhja e fakteve | Error! Bookmark not defined. |
| 2. | Vlerësimi ligjor | 1 |
| (a) | Jurisdikcioni i Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës | 1 |
| (b) | Forma e kontratës | 2 |
| (c) | Çështjet e pagesës..... | 2 |
| (d) | Ndëshkimet financiare | 3 |
| 3. | Vendimi..... | 3 |

1. PËRMBLEDHJA E FAKTEVE

Me datë 22.04.2009, paditësi “Kompania A”, në cilësinë e shitësit dhe i padituri “Kompania B”, në cilësinë e blerësit, kanë lidhur kontratë për shitblerjen e mallit. Në bazë të kësaj kontrate, shitësi ka marrë detyrimin që t’i liferojë blerësit kalda elektrike për nxemje qëndrore të tipit TEK/ 10 KË dhe të tipit TEK/ 20 KW, ndërsa blerësi ka marrë detyrimin që shitësit t’ia paguaj çmimin prej 260€, për secilën kalda të shitur.

Me datën 21.07.2011, shitësi i’ a ka liferuar blerësit 100 kalda elektike.

Me datën 13.08.2010, shitësi i ka dërguar blerësit një vërejtje me shkrim me të cilën e ka ftuar që të bëjë pagesën e çmimit, përndryshe do të jetë i detyruar që të filloj procedurën për realizimin e kërkesës.

I padituri ka deklaruar që të dyja kompanitë kishin një marrëveshje gojore me anë të së cilës ishin dakorduar që i padituri mund të përmbushte obligimet kontraktuale që ka ndaj paditësit, duke paguar shumën e caktuar me anë të transfereve bankare ose, mund t’i përmbushë me kompenzim, me mallrat që i prodhon apo i tregton i padituri. Poashtu, i padituri thekson se një pjesë të këtyre detyrimeve në shumën prej 5,470.00 €, veçse e ka përmbushur duke e kompenzuar me mallrat që prodhon, ashtu që borxhi kontraktues i mbetur të jetë 20,530.00€.

Me datën 21.07.2011, paditësi ka paraqitur padi në Tribunalin e Përhershëm të Arbitrazhit, pranë Odës Ekonomike të Kosovës, kundër të paditurit, për kompensimin e borxhit në vlerë prej 26,000.00 €. Me nenin 11 të Kontratës së Shitblerjes, palët janë dakorduar që në rast të paraqitjes së ndonjë kontesti lidhur më këtë kontratë, kompetent për zgjidhjen e kontestit do të jetë arbitrazhi pranë Odës Ekonomike të Kosovës.

2. VLERËSIMI LIGJOR

a) Jurisdikcioni i Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës

Tribunali i arbitrazhit ka konstatuar se ka jurisdikcion për të vendosuar mbi padinë e ngritur nga ana e paditësit, në bazë të rregullave të arbitrazhit në Kosovë të vitit 2011. Kjo në bazë të nenit 10 të Kontratës së Shitblerjes e cila përcakton, qëndrimin e palëve që për çdo çështje kontestuese që mund të lind nga kjo kontratë, për zgjidhjen e tyre të jetë kompetente Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit. Tribunali arbitrazhit poashtu ka konfirmuar që gjuha që do të përdoret në arbitrazh do të jetë gjuha shqipe dhe vendi i arbitrazhit për shqyrtimin e kësaj çështje do të jetë Prishtina.

b) Forma e kontratës

Tribunali i arbitrazhit ka konstatuar se në bazë të nenin 8 të Kontratës së Shitblerjes, asnjë ndryshim apo modifikim i kushteve të kontratës nuk mund të bëhet pa plotësimin apo ndryshimin me shkrim, të nënshkruar nga të dy palët kontraktuese.

I padituri ka deklaruar që në bazë të nenit 69, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, *inter-alia*, palët mund të përfundojnë, plotësojnë ose ndryshojnë kontratën ekzistuese me anë të një marrëveshjeje jo formale, psh. marrëveshje gojore. Bazuar në këtë nen, i padituri ka deklaruar që ka ekzistuar një marrëveshje gojore në mes të palëve, ku palët janë dakorduar që i padituri të përmbush obligimet e tij kontraktuale përmes kompenzimit me të mirat materiale që i prodhon apo tregton, në vend të pagimit të shumës me anë të transfereve bankare. I padituri, gjatë mbrojtjes në padi të paraqitur me 06.10.2011, ka deklaruar që një pjesë e këtyre obligimeve që përmenden në padi janë mbuluar pjesërisht me dërgimin e mallit – gypit të ujit, në vlerë prej 5,470.00 €, gjë e cila zvogëlon borxhin e mbetur nga 26,000.00 € në 20,540.00 €.

Pas interpretimit të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Kontratën e Shitblerjes të nënshkruar nga palët, Tribunali i arbitrazhit erdhi në përfundimin që kontrata nuk ka përmbajtur asnjë pikë që do i'a lejonte të paditurit të kryente obligimet e saj kontraktuale përmes kompenzimit me të mira të tjera materiale. Bazuar në interpretimin e Tribunalit të arbitrazhit, Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve u lë në diskrecionin e palëve mundësinë për të lidhur një marrëveshje formale ose joformale. Nëse palët dakordohen për një lloj të veçantë të kontratës, atëherë asnjë ndryshim i bërë më vonë në atë kontratë nuk do të jetë valid, vetëm nëse për atë ndryshim të dy palët janë pajtuar dhe kanë nënshkruar marrëveshje me shkrim. Kontrata e lidhur ndërmjet palëve në këtë procedurë, është një kontratë e veçantë bazuar në nenin 454, kapitullin VII të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Andaj, Tribunali i arbitrazhit ka vendosur që çdo ndryshim i kontratës duhet të bëhet vetëm me shkrim dhe me pajtimin e të dyja palëve, dhe çdo ndryshim i një lloji tjetër do të konsiderohet jo valid meqenëse palët janë dakorduar në këtë mënyrë në kontratë.

c) Çështjet e pagesës

Pas shqyrtimit që nëse ka pasur apo jo një marrëveshje gojore ndërmjet palëve, Tribunali i arbitrazhit erdhi në përfundim që i padituri nuk ka përmbushur detyrimet e tij duke dërguar mallrat të cilat i prodhon, si formë zëvendësimi për pagesat që është dashur të kryej. Bazuar në të gjeturat e Tribunalit të arbitrazhit, i padituri nuk ka mundur të vërtetoj që këto të mira materiale janë dërguar tek paditësi. Provat tregojnë që këto të mira materiale janë dërguar tek Kompania C, me të cilën paditësi nuk ka pasur asnjë marrëdhënie biznesore, dhe që kjo dërgesë nuk ka pasur asnjë lidhje me kontratën ndërmjet paditësit dhe të paditurit. I padituri po ashtu nuk ka mundur të vërtetoj që paditësi në ndonjë mënyrë ka përfituar nga kjo dërgesë në Kompaninë C. Edhe nëse i padituri do të arrinte të provonte lidhjen e kësaj dërgeseje me paditësin, në bazë të nenit 307 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, debitori nuk mund të përmbush obligimet e tij në para duke dërguar të mira të tjera materiale, dhe as kreditori nuk mund të kërkojë një gjë të tillë.

Tribunali i arbitrazhit ka vendosur që i padituri ka shkelur kontratën duke mos paguar çmimin e cekur dhe pajtuar në kontratë.

d) Ndëshkimet financiare

Tribunali i arbitrazhit shqyrtoi kërkesën e paditësit për pagimin e kamatëvonesës nga ana e të paditurit. Tribunali vendosi që kamata duhet të paguhet nga data 21.07.2011 deri në pagesën e fundit që duhet të bëhet nga ana e të paditurit. Ky përfundim është bazuar në analizën e bërë nga Tribunali se nga cila datë duhet të paguhet kamata. Bazuar në nenin 3 të Kontratës së Shitblerjes, i padituri është dashur të paguaj paditësin në fundin e muajit në të cilin i padituri do të bënte ri-shitjen e secilës kalda elektronike. Koha e pagesës nuk ishte e specifikuar shumë qartë në kontratë, mirëpo varej nga një ngjarje e ardhshme që do të ndodhte. Kjo ngjarje e ardhshme që pritej të ndodhte, ishte, ri-shitja e secilës kaldë elektronike nga ana e të paditurit. Paditësi nuk ka arritur të vërtetonte që i padituri ka qenë me vonesë në pagesë, më herët se data 21.07.2011. Në mungesë të kësaj prove, Tribunali i arbitrazhit vendosi që kamata duhet të llogaritet nga dita në të cilën i padituri ka dorëzuar kërkesën për fillimin e procedurës së arbitrazhit pranë Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit. Tribunali i arbitrazhit po ashtu vendosi që i padituri të paguaj shpenzimet procedurale.

1. Vendimi

Tribunali i arbitrazhit ka vendosur që i padituri ka shkelur kontratën duke mos paguar çmimin e cekur dhetë pajtuar në kontratë. Për më tej, vendosi që i padituri duhet t'i paguaj paditësit kamatëvonesën në bazë të kritereve të përcaktuara nga Banka Qendrore Evropiane në normën prej 1.00% të borxhit kryesor prej 26,000.00 €, të llogaritur nga data 21.07.2011. Poashtu vendosi që i padituri të paguajë shpenzimet procedurale në vlerë prej 1,900.00 €.

Ky Vendim është lëshuar nga Tribunali i arbitrazhit në Prishtinë më 16.12.2011.